

Tirane me 21/05/2020

KAPITULLI I EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA, TERRITORI

Neni 1 Emri

1.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “O3”Sh.p.k, e cila më poshtë do të quhet “Shoqëria”, është themeluar nga ortakët e shoqërise:

- Z. Orion Struga , i biri i Fatmir dhe i Elpiniqi, me datelindje 15/12/1980, lindur dhe banues ne Tiranë, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me nr. ID I01215102K.

dhe

- Z. Olti Pecini, i biri Anastas dhe Valbona, me datelindje 19/08/1977 , lindur dhe banues ne Tirane madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me nr. ID H708191770.

Të cilët në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe mbështetur në Ligjin me Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe me Ligjin me Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit” miratuan dhe nënshkruan edhe këtë statut të shoqërisë “O3” Sh.p.k.

Neni 2 Forma

2.1 Kjo Shoqëri është një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar.

2.2 Themeluesit e saj janë persona fizik, që mbulojnë personalisht humbjet e shoqërise deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara dhe nuk përgjigjen për humbjet e shoqërise tregtare.

Neni 3 Baza juridike

3.1 Shoqëria është krijuar në bazë të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë konkretisht në bazë të Ligjit me Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqërite tregtare” dhe të Ligjit me Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit” dhe, si person juridik, e zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij Statuti. Ajo ka personalitet juridik dhe është e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 4 Selia

- 4.1 Selia e Shoqërisë është në Tiranë në adresën Njesia Administrative nr. 2, Rruga Manol Konomi, ndertesa 14, hyrja 2 ap.2 .
- 4.2 Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të Ortakëve.
- 4.3 Shoqëria do ta konsiderojë selinë e përcaktuar me sipër si Shoqëria Nënë, e cila rast pas rasti mund të hapë degë, filiale ose shoqëri të përbashkëta në të gjitha ato vende ku do të shikojë interes në përmbushjen e qëllimit të saj.

Neni 5 Territori

- 5.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin si në territorin e Republikës së Shqipërisë.

KAPITULLI II OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Neni 6 Objekti

- 6.1 Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj :

Ne fushen e shërbimeve mjekesore, industrial, dentare, farmaceutike, mjedisore dhe laboratoriet universitare. Import dhe Eksport me shumice dhe pakice të pajisjeve mjekesore, reagente, materiale konsumi, pjese kembimi, preparateve farmaceutike, pajisje didaktike, pajisje analitike. Mirembajtje, riparim dhe trajnim teknik i të gjitha pajisjeve mjekesore, spitalore, didaktike dhe analitike, trajnime dhe konsulenca teknike për përdorim të pajisjeve mjekesore, didaktike dhe analitike. Fushata për ndergjegjesimin e publikut, trajtimi i mjeteve të transportit për kujdesin shëndetësor etj. Qender diagnostike mjekesore, qender kurative mjekesore. Studime dhe aplikime në fushën e mjekësisë. Pajisje mobilimi, pajisje IT, furnizim dhe instalim të pajisjeve software të cilësive së lartë, PC, servera, printera, fotokopje, asistencë teknike, riparime, instalime dhe konfigurime të sistemeve të përpunimit të të dhënave, instalim i rrjeteve kompjuterike, telekomunikacionit dhe mirembajtje e tyre. Pajisje kërkimore industriale, pajisje dhe aksesore për fushën e arkelogjisë, mjedisit dhe veterinarisë

Shërbime dezinfektimi, dezinfektimi, Deratizim dhe trajtimi me gaz dezinfektues për produktet në gjendje ruajtje si grurë, misër, oriz, kafë. Dhënie me qira të pajisjeve për shërbimin e dezinfektimit, dezinfektimit, deratizimit, pastrimit dhe higjienizimit. Prodhimin dhe shitjen me shumicë e pakicë të produkteve dhe pajisjeve të pastrimit, higjienizimit të ambienteve të banimit, publike dhe industriale. Prodhimin dhe shitjen me shumicë dhe pakicë të produkteve dhe pajisjeve të pastrimit dhe higjienizimit personal. Prodhimin dhe shitjen me shumicë e pakicë të produkteve dhe pajisjeve për dezinfektimin, dezinfektimin, deratizimin. Importeksport, tregtim me shumicë dhe pakicë të pajisjeve dhe produkteve për dezinfektim, dezinfektim, deratizim dhe gaz dezinfektues, produkteve dhe pajisjeve mbrojtëse së bimëve, produkteve dhe pajisjeve të pastrimit dhe higjienizimit. Agjent dhe shpërndarës për shitjen me shumicë e pakicë të produkteve dhe pajisjeve të firmave të huaja, për dezinfektimin, dezinfektimin, deratizimin, të pastrimit, higjienizimit të ambienteve të banimit, publike dhe industriale, të pastrimit dhe higjienizimit person.

Neni 7 Kohëzgjatja

7.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKR, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj, në statut ose me vendim të Ortakëve.

KAPITULLI III AUTORITETI I ORTAKUT, LIBRI I SHOQËRISË, KONFIDENCIALITETI

Neni 8 Fusha e autoritetit të ortakëve

8.1 Fusha e autoritetit të ortakut dhe përqindja e fitimeve ose humbjeve do të kenë si kriter bazë kapitalin e Shoqërisë, si dhe kompetencat që gëzon ortakut në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuara në këtë statut dhe ligjin "Për tregtarët dhe shoqërite tregtare".

Neni 9 Libri i Shoqërisë

9.1 Për të saktësuar veprimtarinë e vet ekonomike si dhe marrëdhëniet e punës, Shoqëria do të çelë librin e vet, i cili do të quhet Libri i Shoqërisë.

Neni 10 Konfidencialiteti

10.1 Personat e pranuar në Shoqëri, duhet të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë Shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë, çdo lloj materiali, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

Neni 11 Dokumentet e destinuar për të tretët

11.1 Të gjitha aktet dhe dokumentet që nxirren nga Shoqëria dhe të destinuar për të tretët, si letrat, faturat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme, etj. duhet të tregojnë lexueshëm emrin e Shoqërisë dhe pas tij fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose inicialet "Sh.P.K.", si dhe emrin e administratorit.

KAPITULLI IV KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE TE SHOQËRISË

Neni 12 Kapitali themeltar



STATUTI I SHOQËRISË “O3” SH.P.K

- 12.1 Kapitali themeltar i Shoqërise do të jetë 100,000 (njqind mije) **lekë**, I ndare ne 2 kuota me vlere nominale 50,000 Leke Secila.
- 12.2 Kapitali themeltar eshte teresisht i shlyer dhe i nenshkruar nga ortaket.
- 12.3 Pergjegjesia e ortakeve kufizohet deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin e shoqerise.
- 12.4 Kontributi i anetareve ne shoqeri eshte:
- Z. Orion Struga zoteron 1 (nje) kuote, me vlere nominale 50,000 (pesedhjete mije) Leke, qe perfaqesojne 50% (pesedhjete %) te kapitalit te shoqerise.
 - Z. Olti Pecini zoteron zoteron 1 (nje) kuote, me vlere nominale 50,000 (pesedhjete mije) Leke, qe perfaqesojne 50% (pesedhjete %) te kapitalit te shoqerise.
- 12.5 Ky kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortakët. Shoqëria mund ta shtojë ose zvogëlojë kapitalin, në varesi të nevojave dhe rezultateve të saj me vendim të Ortakëve.

Neni 13

Mënyrat e fitimit dhe të kalimit të kuotave

- 13.1 Kuotat e shoqërise janë fituar nga ortaket me kontributin e tyre financiar në kapitalin e shoqërisë.
- 13.2 **E drejta e parablerjes.** Nese njeri nga ortaket deshiron t'i shese, transferoje apo ne ndonje menyre tjeter t'i disponoje ndonje apo te gjithë kuotat e tij (kjo pale do quhet shitesi), ortaku tjeter (pranuesi i ofertes) do te kete te drejten e perparesise ne blerjen e ketyre kuotave (kuotat e ofertuara).
- 13.3 Nese pranuesi i ofertes refuzon blerjen e kuotave refuzimi duhet te jete me shkrim dhe me pas shitesi ka te drejten qe Kuotat e shoqërisë mund të kalojnë lirisht tek personat e tretë me shitblerje.
- 13.4 Gjithashtu kuotat e shoqërisë mund të kalojnë me rrugë trashëgimie. Bashkëshorti/tja, paraardhësit dhe pasardhësit mund të bëhen ortak nepermjet kalimit të kuotave sipas kushteve që lejohen në ligj.
- 13.5 Kalimi i kuotave të shoqërisë me shitblerje bëhet me kontratë me shkrim dhe të vërtetuar me akt noterial.

KAPITULLI V

STRUKTURA, ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 14

14.1 Organet Drejtuese

Si organe drejtuese të Shoqërisë janë;

1. Mbledhja e Ortakëve të Shoqërisë.
2. Administratori.

Neni 15 Kompetencat e Ortakëve

- 15.1 Kompetencat e Ortakëve do të jenë:
- Përcaktojnë politikat tregtare të shoqërisë
 - Vendosin për ndryshimet në Statutin e Shoqërisë, kalimin e kuotave, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë
 - Emerojnë dhe shkarkojnë administratorin e shoqërisë
 - Mbikeqyrjen e politikave tregtare nga administratori
 - Emërimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe të eksperteve kontabël të autorizuar
 - Vendosin për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
 - Shqyrtojnë bilancin vjetor, përcaktojnë llojet e fondeve të ndryshme dhe masën e tyre, fitimin e realizuar si dhe vendosin për ndarjen e dividendeve.
 - Vendosin për krijimin e degëve (filialeve) ose të përfaqesive si dhe për krijimin e shoqërive me persona të tjere fizike apo juridikë

Neni 16 Vendim-marrja e Ortakëve

- 16.1 Administratori ose eksperti kontabël i autorizuar (nese ka te tille), ose likujduesi mund të propozojnë dhe të kërkojnë shqyrtimin e ceshtjeve të ndryshme nga ortakët e shoqërisë.
- 16.2 Njoftimi bëhet me shkresë ose përmes postës elektronike ku përshkruhet çështja dhe propozimi konkret.

Neni 17 Administratori dhe kompetencat e tij

- 17.1 Shoqëria do të ketë një administrator, i cili emërohet nga mbledhja e Ortakëve. Administrator i shoqërisë është **Z. Orion Struga**.
- 17.2 Administratori pervec të tjerave ka të drejtë dhe detyrohet:
- Të administrojë veprimtarine tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Ortakët e shoqërisë.
 - Të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë.
 - Të pergatise dhe te nenshkruaje bilancin vjetor te shoqërisë, bilancin e konsoliduar dhe propozon shpërndarjen e fitimeve duke kërkuar për këto miratimin e Asamblesë së Përgjithshme.
 - Të rregjistroje të dhënat e detyrueshme të shoqërisë në QKB;
 - Të raportojë përpara Ortakëve për realizimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - Të koordinojë veprimtarinë e personave të punësuar në Shoqëri;
 - Të përfaqesoje Shoqërine ne marrëdhënie me organet shtetërore dhe me personat e trete, si dhe në Gjykatë.
- 17.3 Emërimi i administratorit do të bëhet për një afat prej 5 vjecar me të drejtë riemërimi.
- 17.4 Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave sipas standarteve të kërkuara.

STATUTI I SHOQËRISË “O3” SH.P.K

17.5 Emërimi dhe Shkarkimi i administratorit bëhet me vendim të Ortakëve të shoqërisë.

KAPITULLI VI LIBRAT E SHOQËRISË, BILANCI, DIVIDENTET

Neni 18 Librat e Shoqërisë

18.1 Shoqëria është e detyruar të mbajë, përveç Librit të Shoqërisë, në të cilin shënohet emri i plotë i ortakëve, vendimet e asamblesë së ortakëve dhe dokumentacionin kontabël dhe librat e tjerë.

Neni 19 Bilanci

19.1 Bilanci mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti. Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar, raportet e hartuara nga eksperti kontabël i autorizuar, propozizimet për ndarjen e fitimeve nënshkruhen nga administratori dhe miratohen nga mbledhja e Ortakëve të Shoqërisë.

19.2 Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

Neni 20 Dividentet

20.1 Mbledhja e Ortakëve të shoqërisë miraton llogaritë vjetore dhe evidenton ekzistencën e fitimit, përcakton fitimin e vitit financiar, të cilit pasi i janë zbritur shumat e lëna mënjatë për: rezervën sipas ligjit ose të përcaktuar nga mbledhja e Ortakëve, fondet e tjera që shihen të nevojshme dhe, pasi janë zbritur ose shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme, përcakton dhe dividentin. Mbledhja e Ortakëve vendos dhe për ndarjen e dividentit.

Neni 21 Marrëdhëniet e Punës

21.1 Marrëdhëniet e punës në shoqëri gjejnë rregullim në kontratën e punës, në Kodin e Punës dhe në aktet e tjera që kanë dalë në zbatim të këtij kodi.

KAPITULLI VII LIKUJDIMI DHE PRISHJA E SHOQËRISË.

Neni 22 Mbarimi

22.1 Shoqëria priset:

- me vendim të mbledhjes së Ortakëve
- me hapjen e procedurave të falimentimit

STATUTI I SHOQËRISË “O3” SH.P.K

- nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë së saj në QKB
- me vendim të gjykatës

22.2 Në të gjitha rastet Ortakët i Shoqërisë duhet të rregjistrojnë prishjen e shoqërisë në QKR në përputhje me nenet 43 dhe 45 të Ligjit me Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendren Kombëtare të Rregjistrimit”

Neni 23

Likujdimi i shoqërisë

- 23.1** Prishja e shoqërisë në gjendjen e aftesisë paguese bëhet me procedurën e likujdimit të shoqërisë kur nuk është nisur procedurë falimentimi.
- 23.2** Ky fakt rregjistrohet në QKB, duke shtuar tek emri i shoqërisë shënimin “në likujdim”
- 23.3** Për të ndjekur procedurën e likujdimit mbledhja e Ortakeve emëron një likujdues.
- 23.4** Nëse shoqëria priset me vendim gjykate, likujduesi emërohet nga Gjykata.
- 23.5** Shkarkimi i likujduesit bëhet me të njëjtën mënyrë siç bëhet dhe emërimi i tyre
- 23.6** Në rast prishje shoqëria do të përpiqet të aplikojë likujdimin e thjeshtëzuar në përputhje me dispozitat e neneve 204 dhe 206 të Ligjit me Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

KAPITULLI VII

MOSMARRËVESHJET DHE DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 24

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

24.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likujdimit ortakët dhe administratori do të përpiqen ti zgjidhin me mirëkuptim dhe nëse kjo nuk arrihet, do t'i paraqiten për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë, seksionit tregtar.

Neni 25

Dispozita të fundit

- 25.1** Pasuria e Shoqërisë mund të sigurohet në ndonjë Institut Sigurimi si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë.
- 25.2** Shoqëria do të ketë vulën e saj, forma dhe madhësia e së cilës përcaktohen nga Ortakët.
- 25.3** Ky Statut është hartuar në 3 (tre) ekzemplarë, në gjuhën shqipe duke patur secili ekzemplar fuqi të njëjtë ligjore.
- 25.4** Ngarkohet Administratori, z. Orion Struga, me datelindje 15/12/1980, lindur dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotesi të plote juridike për të vepruar, identifikuar me nr. ID I01215102K.

ORTAKET E SHOQËRISË

Z. ORION STRUGA



Z. OLTI PECINI

